

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti si kryetar i kolegjit, Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Erdogan Haxhibeqiri dhe Nebojša Borčić si anëtarë të kolegjit, në praninë e këshilltares ligjore të EULEX-it Lendita Berisha, si procesmbajtëse,

në lëndën penale kundër të pandehurit:

**O.2.** Emri i të atit ~~XXX~~ emri i nënës ~~XXX~~, i lindur më ~~(XXX)~~ në fshatin ~~XXX~~ Komuna e ~~XXX~~ Kosovë, me shtetësi të Kosovës, adresa e ferdit e banimit, rruga ~~XXX~~, biznesmen, ka të kryer shkollën e mesme, i ~~XXX~~ ka të ~~XXX~~ tani në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

I dënuar në shkallën e tretë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 4 shtator 2013, 2013 (PAII no.3/2013), dhe i shpallur fajtor për kryerje të veprave penale:

- Pika 1: **Vrasje**, të kryer më 10 tetor 2005 në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor, në kundërshtim të nenit 146 lidhur me nenin 23 dhe nenin 12 paragrafin 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së),
- Pika 2: **Vrasje në tentativë**, të kryer më 10 tetor 2005 në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor, në kundërshtim të nenit 146 lidhur me nenin 20, nenin 23 dhe nenin 12 paragrafin 2 të KPPK-së,
- Pika 3: **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, të kryer më 10 tetor 2005, në kundërshtim të nenit 374 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK, në fuqi prej 1 janar 2013)
- Pika 4: **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, të kryer më 19 prill 2007, në kundërshtim të nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së;

Duke u bazuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, të datës 9 dhjetor 2013 (PK.no.96/13), të korrigjuar me aktvendimin e datës 16 dhjetor 2013 (PK.no.96/13), ku në përputhje me dispozitat e Ligjit për Amnistinë, Gjykata Themelore e amnistoi të pandehurin për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga Pika 4 dhe e dënoi të pandehurin me **dënim të ri unik me njëmbëdhjetë (11) vjet e gjashtë (6) muaj burgim**, ku në dënimin e shqiptuar llogaritet koha e kaluar në paraburgim (prej 19 prill 2007);

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 20 dhjetor 2013 nga avokati mbrojtës **E.R.**, dhe duke marrë parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK) të datës 8 janar 2014;

Pas këshillimit dhe votimit, në përputhje me nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (KPK), Gjykata Supreme lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 20 dhjetor 2013 nga avokati mbrojtës **E.R.** në emër të të pandehurit **O.Z.**, kundër aktgjykimit PAII no.3/13 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 3 shtator 2013 refuzohet si e pabazuar.

## ARSYETIMI

### I. Historiku i procedurës

Më 16 korrik 2007, prokurori publik i qarkut të Prizrenit ka përgatitur aktakuzën PP nr. 230/2005, kundër të pandehurit **O.Z.** dhe një kryerësi të dytë të pretenduar, e cila u ngrit në Gjykatën e Qarkut në Prizren. Të dy të pandehurit ishin akuzuar për veprat penale të (Pika 1) vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 147 paragrafin 4, 5, 8 dhe me nenin 23 të KPPK-së; (Pika 2) të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 147, paragrafin 11, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së; (Pika 3) të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 1 dhe 2 të KPK-së, dhe vetëm i pandehuri **O.Z.** (Pika 4) është akuzuar edhe për një pikë tjetër të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së.

Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin P.Nr.155/2007 të datës 17 prill 2008 ka shpallur të pandehurin **O.Z.** fajtor për veprat penale **Vrasje e Rëndë** në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) të kryer në bashkëkryerje nga neni 23 i KPPK-së, për **Vrasje e Rëndë në Tentativë** në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 11 dhe nenit 20 të KPPK-së, të kryer në bashkëkryerje nga neni 23 i KPPK-së, për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së dhe për një pikë tjetër të veprës penale **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe dënohet me dënim unik me njëzet e pesë (25) vjet burgim.

Më 21 korrik 2009, kolegji i apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës (si gjykatë e shkallës së dytë) kishte nxjerrë aktgjykimin AP.-KŽ.481 /2008, pas ankesave të paraqitura nga mbrojtja. Sa i përket të pandehurit **O.Z.**, Gjykata Supreme e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket cilësimit juridik të pikave 1 dhe 2 të cilësuar si një **vrasje e rëndë**, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 11 të KPPK-së, dhe sa i përket cilësimit juridik të pikës 3 ku thuhet se i pandehuri **O.Z.** ka kryer veprën penale **mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së, ku ishte në posedim të armës më 10 tetor 2005 në fshatin ~~XXX~~ komuna e Prizrenit. Pjesët e tjera të aktgjykimit janë konfirmuar.

Avokati mbrojtës ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës (si gjykatë në shkallë të tretë), me aktvendimin API.-KŽI. Nr. 9/2009, të datës 28 dhjetor 2010, e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.-KŽ. Nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009. Lënda u kthye për rigjykim në Gjykatën Supreme si gjykatë e shkallës së dytë.

Më 6 nëntor 2012 Gjykata Supreme e Kosovës, prapë si gjykatë e shkallës së dytë, me aktgjykimin AP-KZ no.110/2011, e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë. I pandehuri u shpall fajtor për veprat penale (Pika 1) **vrasje** në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor në kundërshtim me nenin 146 të KPPK-së lidhur me nenin 12 paragrafin 2 dhe me nenin 23 të KPPK-së; dhe (Pika 2) **vrasje në tentativë** në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor, në kundërshtim me nenin 146 lidhur me nenin 20, nenin 23 dhe nenin 12 të KPPK-së; dhe (Pika 4) **mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-s. Gjykata konsideroi se vepra penale (Pika 3) ishte konsumuar nga pikat 1 dhe 2. Gjykata e dënoi të pandehurin për pikat 1 dhe 2, në përputhje me nenin 147 paragrafin 1 pikën 11 të KPPK-së, me dënim të vetëm me katërmbëdhjetë (14) vjet burgim dhe për pikën 4 me dy (2) vjet burgim, që rezulton me dënim unik me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.

Pas ankesave të paraqitura nga avokati mbrojtës *E.R.* dhe nga Prokurori i Shtetit i Kosovës, më 4 shtator 2013 Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë me aktgjykimin PAII no.3/13 e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës si shkallë e dytë AP-KZ No.110/2011 (të datës 6 nëntor 2012), dhe e shpalli të pandehurin fajtor për veprat penale (Pika 1) **vrasje** në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor në kundërshtim me nenin 146 lidhur me nenin 23 dhe nenin 12 paragrafin 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK); (Pika 2) **vrasje në tentativë** në bashkëkryerje në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor, në kundërshtim me nenin 146 lidhur me nenin 20, nenin 23 dhe nenin 12 paragrafin 2 të KPPK-së; (Pika 3) **mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, dhe (Pika 4) **mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, të dy pikat në kundërshtim me nenin 374, paragrafin 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK në fuqi prej 1 janarit 2013). Gjykata Supreme e dënoi të pandehurin *O.Z.* me dënim unik me dymbëdhjetë (12) vjet burgim, duke llogaritur në dënimin e shqiptuar kohën e kaluar në paraburgim prej 19 prill 2007.

Sa i përket pikës 3 Gjykata Supreme në arsyetimin e vet thekson se aktakuza po ashtu ka përfshirë elementet e tjera përveç shfrytëzimit të armëve, përkatësisht mbajtjes në pronësi, në kontroll dhe në posedim të armëve. Veprat penale të vrasjes dhe veprat penale të armëve përmbajnë elemente të ndryshme dhe janë të drejtuara kundër vlerave të ndryshme të mbrojtura të shoqërisë. Vepra penale e armëve përmban një rrezik domethënës për shoqërinë. Prandaj, Gjykata Supreme arriti në përfundim se vepra penale e armëve duhet të dënohet veçmas. Po ashtu gjykata e zbatoi nenin 374 paragrafin 1 të KPRK-së (në fuqi prej 1 janarit 2013) si ligjin më të favorshëm për të pandehurin.

Sa i përket dënimit Gjykata Supreme pohon se i pandehuri është shpallur fajtor për kryerje të veprave penale të vrasjes dhe të vrasjes në tentativë (në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor), të cilat janë dy veprime të veçanta penale. Përveç kësaj, është kryer vetëm një vrasje. Për këto arsye i pandehuri nuk mund të dënohet për pikat 1 dhe 2 në

përputhje me nenin 147 pikën 11 të KPPK-së me një dënim të vetëm. Prandaj, Gjykata Supreme e ka dënuar të pandehurin veçmas për secilën pikë të akuzës: për pikën 1 tetë (8) vite burgim, për pikën 2 katër (4) vite burgim, për pikën 3 një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim dhe për pikën 4 gjashtë (6) muaj burgim. Dënimi unik ka qenë dymbëdhjetë (12) vite burgim.

Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren sipas neneve 2 dhe 3 paragrafit 1.2 pikës 1.2.5 dhe nenit 7 paragrafit 1 pikës 1.1 të Ligjit për Amnisti (04/L-209) ka amnistuar të pandehurin **O. E.**, për veprën penale **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në pikën 4, sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së. Dënimi për veprën penale në pikën 4 është hedhur poshtë. Prandaj, Gjykata e Qarkut ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 4 shtator 2013 (PA.II.nr.3/2013) dhe ka shqiptuar një dënim të ri unik prej njëmbëdhjetë (11) viteve dhe gjashtë (6) muajve burgim (Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren PK.nr.96/13 i datës 9 dhjetor 2013 është korrigjuar me aktvendimin e datës 16 dhjetor 2013).

Më 20 dhjetor 2013, avokati mbrojtës **E.R.** në emër të pandehurit **O.Z.** a paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimin të Gjykatës Supreme të datës 4 shtator 2013. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të nenit 402 paragrafit 1, nën-paragrafit 1 në lidhje me nenin 403 paragrafin 1 nën-paragrafin 12 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) dhe shkelje të nenit 402 paragrafit 1 nën-paragrafit 2 në lidhje me nenin 404 nën-paragrafin 2 të KPPK-së. Ai i propozon Gjykatës Supreme që t'i ndryshojë apo anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe aktgjykimet e mëparshme të gjykatave të instancave më të ulëta.

Më 9 janar 2014, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) ka paraqitur përgjigje në kërkesën e të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë. Në përgjigjen e saj, Prokurori i Shtetit ka pohuar se mbrojtja nuk ka paraqitur fakte të tilla të cilat nuk janë marrë parasysh dhe gjykuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Sipas ZPSHK-së, Gjykata Supreme tashmë ka vlerësuar dhe ka vendosur drejtë mbi çështjet e ngritura në kërkesë nga mbrojtja. Prandaj, konsideron se kërkesa është jo meritore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e kontestuar.

## II. Gjetjet e Gjykatës

Gjykata Supreme gjen se:

- a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme (e paraqitur me kohë pranë gjykatës kompetente nga personat e autorizuar në pajtim me nenin 432 paragrafin 4 dhe nenin 433 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së).
- b. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës paraprakisht i referohet nenit 432 të KPP-së, i cili përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm dhe gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e shkeljeve eventuale në interpretimin apo zbatimin e ligjit.

Sipas nenit 436 të KPP, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizohet vetëm në ekzaminimin e shkeljeve të ligjit material dhe të procedurës sipas pretendimit të avokatëve mbrojtës.

Meritat e lëndës:

a. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtja pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nën pikat I – III është i pakuptueshëm dhe nuk përmban figurën ligjore të veprës penale. Sipas tij, gjykata ka dështuar që të jap përshkrimin e veprimeve të cilat janë karakteristika të këtyre veprave penale.

Gjatë shqyrtimit të kësaj pike kolegji nuk ka mundur të vërtetojë asnjë mangësi substanciale në lidhje me dispozitivin e aktgjykimit të apeluar. Kolegji gjen se dispozitivi i aktgjykimit të apeluar është mjaftueshëm i qartë dhe i kuptueshëm. Kolegji vëren se përshkrimi faktik siç është vërtetuar një herë nga gjykata e shkallës së parë ka mbetur i pandryshuar gjatë gjithë procedurës penale. Vetëm cilësimet juridike të veprave penale të kryera nga të pandehurit i janë nënshtruar ndryshimeve (në instanca më të larta), të cilat janë bërë të gjitha brenda kornizës së të njëjtit përshkrim faktik të veprimeve penale. Prandaj, pretendimet e mbrojtjes në lidhje me këtë çështje refuzohen si të pabazuara.

b. Mbrojtja pohon se cilësimi i veprave penale nën pikat I dhe II të dispozitivit nuk korrespondon me arsyetimin. Avokati mbrojtës thekson ekzistimin e kundërthënies sa i përket gjetjeve të gjykatës se i pandehuri ka kryer veprën penale me paramendim dhe faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale në gjendje të aftësisë mendore të zvogëluar. Sipas tij gjykata nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me faktet vendimtare.

Kolegji nuk sheh asnjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit. Përkundrazi, kolegji vëren se çështjet e kryerjes së veprës penale në *gjendje të aftësisë mendore të zvogëluar* në njërën anë dhe *paramendimit* në anën tjetër janë të natyrave të ndryshme. Pra, nëse rrethana e parë ekziston, nuk do të thotë domosdoshmërisht se rrethana e dytë duhet patjetër të përjashtohet. Ky kolegji plotësisht pajtohet me mendimin e Gjykatës Supreme se fakti se i pandehuri ka kryer veprën penale në bashkëkryerje paraqet faktin se së paku ka ekzistuar një shkallë të planifikimit për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar. Kjo gjithashtu thekson se i pandehuri ka aftësi që të kontrollojë veprimet e tij edhe pse ka personalitet të çrregulluar për shkak të cilit aftësia e tij që të abstenojë nga aktet penale është zvogëluar. Prandaj, pretendimet e mbrojtjes refuzohen si të pabazuara.

Sa i përket çështjes së fakteve vendimtare, kolegji gjen se Gjykata Supreme në arsyetimin e saj ka sqaruar rrethanat në bazë të të cilave ka konstatuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. Më tutje, ky kolegji vëren se avokati mbrojtës vetëm ka cituar dispozitat e procedurës penale pa treguar se cilat fakte nuk janë arsyetuar mjaftueshëm. Nuk është adekuate të pretendohet se gjykata nuk ka arsyetuar mjaftueshëm faktet vendimtare nëse faktet nuk janë specifikuar dhe sqaruar. Detyra e avokatit mbrojtës duhet të jetë që të tregoj faktet në mënyrë të qartë dhe të ofroj sqarime bindëse në lidhje me pretendimet.

c. Mbrojtja pretendon në shkelje të ligjit penal pasi që gjykata nuk ka zbatuar nenin 148 të KPK-së. Sa i përket veprës penale Vrasje në tentativë, mbrojtja pohon se i pandehuri nuk ka pasur për qëllim që të kryej këtë veprë penale dhe gjykata ka dështuar që të ofroj arsye se si ka përcaktuar cilësimin juridik dhe ekzistimin e dashjes. Vepra mund të cilësohet

vetëm si vepër penale Lëndim i rëndë trupor sipas nenit 154 paragrafit 1, nën-paragrafit 1 të KPK-së.

Kolegji vëren se pretendime të tilla tashmë ishin bërë nga avokati mbrojtës në shkallë të tretë (kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë) dhe janë adresuar në hollësi në aktgjykimin e Gjykatës Supreme (faqe 11 -13). Kolegji pajtohet me përfundimin e aktgjyqimit të apeluar dhe thekson se elementi i dashjes është arsyetuar. Nuk ka asnjë shkelje të ligjit siç pretendohet nga avokati mbrojtës.

Në bazë të asaj që u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtëse:

.....  
Timo Vuojolahti  
Gjyqtar i EULEX-it

.....  
Lendita Berisha  
Këshilltare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

.....  
Erdogan Haxhibeqiri  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

.....  
Nebojsa Boricic  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PML – KZZ nr. 237/2013  
22 maj 2014  
Prishtinë